

VENDIM
Nr. 17, datë 3.4.2013

PËR LICENCIM PËR HERË TË PARË NDËRMARRJA UJËSJELLËS DIVJAKË

Në mbështetje të nenit 14 pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Licencim për herë të parë Ndërmarrja e Ujësjellësit Divjakë me:
 - drejtues ligjor, Josif Kruti;
 - drejtuese teknike, Sonila Sako.
2. Operatori Ndërmarrja e Ujësjellës Divjakë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:
 - Kategoria A për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.
3. Zona e mbulimit të këtij operatori është bashkia Divjakë.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare, deri në datën 2.4.2017.

KRYETARI
Avni Dervishi